



Partia Liberale Egjiptiane

Pasqyrat Financiare Vjetore dhe Raporti i Auditorëve të pavarur

01 Janar 2014 - 31 Dhjetor 2014

Përmbajtja:

Raport i auditorëve të Pavarur..	3
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	6
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	7
Shënimet e pasqyrave financiare.....	8-11

Raport i Auditorëve te pavarur

Drejtuar Kryesisë së Partisë Liberale Egjiptiane

Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

Mohim i opinionit

Ne kemi qenë të angazhuar për të audituar raportet financiare të bashkëngjitura të Subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (në vijim referuar si “Subjekti Politik” apo “PLE” apo “SP”), të përbëra nga pasqyra e Pozitës Financiare me 31 Dhjetor 2014, pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën e përfunduar me këtë datë, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira në fq. 6-11.

Ne nuk shprehim një opinion mbi raportet financiare të subjektit Partia Liberale Egjiptiane. Për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në paragrafin bazat për mohim të dhënies së opinionit, ne nuk kemi qenë në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme të auditimit për të patur një bazë për një opinion të auditimit.

Bazat për mohim të Opinionit

- Siç është prezantuar në pasqyrën e Pozitës financiare të bashkëngjitur, detyrimet dhe fondet e subjektit politik tejkalojnë asetet e SP për 4,640.25 euro me 31 Dhjetor 2014 si pasoj ka një mos barazim në mes të aseteve të prezantuara dhe burimeve të financimit, duke pasur parasysh natyrën e shënimeve që ka mbajtur SP në e kishim të pamundur të përcaktojmë nëse SP ka mbivlerësuar burimet e financimit apo ka nënvlerësuar asetet e prezantuara.
- Subjekti politik nuk ka dorëzuar në KQZ raportin bankar për vitin 2014 ashtu siç kërkohet me ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar. Ne mungese të dokumentacionit mbështetës në e kishim të pamundur të verifikojmë nëse gjendja e bankës e raportuar është e sakte dhe njëkohësisht nëse të hyrat dhe shpenzimet e raportuar prezantojnë drejt aktivitetin e raportuar të SP.
- Gjatë auditimit tonë ne kemi vërejtur që SP nuk ka prezantuar gjendjen e parasë dhe ekuivalentëve të parasë në fillim dhe në fund të periudhës raportuese, kjo ka ndikuar në një prezantim jo real të aseteve të SP dhe një prezantim jo korrekt të gjendjes financiare me këtë datë raportuese.
- SP ka paguar paga dhe kompensime në vlerë prej 2,290.00 Euro si dhe qira në vlerë prej 1,000.00 ,por që nuk janë përlllogaritur dhe deklaruar tatimet dhe kontributet si tatim në burim bazuar në Ligjin Nr.03/L-161 për Tatimin në të Ardhura Personale sipas kërkesës nga neni 6 dhe 7 i Ligjit.

Theksim i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Subjekti Politik nuk ka mirëmbajtur një kontabilitet të mirëfilltë për të mundësuar regjistrimin e transaksioneve financiare dhe përgatitjen e pasqyrave financiare sipas standardeve të kontabilitetit të aplikueshme në Kosovë.
- Subjekti Politik e ka të definuar me Statut, mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar të saj, por nuk e aplikon, dhe, të drejtën e anëtarëve për t'u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjës për transaksione financiare, ashtu siç parashihet në ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 17 Kontrolli i Brendshëm.
- Subjekti Politik nuk ka respektuar kërkesat ligjore në lidhje me publikimin e raporteve financiare vjetore dhe të fushatës sipas ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar, paragrafi 5.1 dhe 5.2.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre të ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpалosjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitetit sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë.

Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit & Conto sh.p.k

Muhamet Feka
Auditor Ligjor
30 Nëntor 2017

Pasqyra e Pozitës Financiare

Pasuritë		Me 31 Dhjetor 2014	Me 31 Dhjetor 2013
Pasuritë afatgjata	Shënimi	Shuma në Euro	Shuma në Euro
Toka, objektet dhe pajisjet	2	2,646.00	
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë tjera afatgjata			
Total pasuritë afatgjata		2,646.00	
Pasuritë afatshkurtra			
Llogaritë e arkëtueshme		0.00	
Parapagimet			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë		0.00	
Pasuritë tjera afatshkurtra		0.00	
Total pasuritë afatshkurtra		0.00	
Total pasuritë		2,646.00	
Ekuiteti			
Fondet e akumuluar		0.00	
Suficiti / (deficiti) i vitit		4,640.25	
Total Ekuiteti		4,640.25	
Detyrimet			
Detyrimet afatgjata			
Huatë e pagueshme			
Të hyrat e shtyera		2,646.00	
Gjithsej detyrimet afatgjata		2,646.00	
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera		0.00	
Huatë e pagueshme			
Detyrimet tjera afatshkurtra		0.00	
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		0.00	
Gjithsej detyrimet		2,646.00	
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		7,286.25	

Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve

Viti që përfundon me 31 Dhjetor			
	Shënimi	2014	2013
Të hyrat			
Të hyrat nga buxheti		15,745.00	
Të hyrat nga anëtarësia			
Donacionet dhe kontributet në të holla		0.00	
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime			
Të hyrat e fushatës			
Te hyrat e liruar nga te hyrat e shtyera		0.00	
Të hyrat tjera			
Gjithsej të hyrat për vitin		15,745.00	
Shpenzimet			
Pagat dhe kompenzimet	3	2,290.00	
Shpenzimet e transportit	3	1,502.00	
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	3	3,457.95	
Shpenzimet e fushatës	3	0.00	
Blerja e mallrave	3	851.00	
Shpenzimet e përgjithshme	3	2,956.00	
Shpenzimet e ndryshme	3	47.80	
Gjithsej shpenzimet për vitin		11,104.75	
Suficiti / (deficiti) për vitin		4,640.25	

1. Informata te përgjithshme

Partia Liberale Egjiptiane është regjistruar sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Rregullores nr. 01-2013 të KQZ-së mbi regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike.

Kjo parti politike është regjistruar më 29/04/2014 me numrin regjistruar : 197-0414

Statusi i tanishëm dhe i ardhshëm i regjistrimit të kësaj partie politike varet nga veprimi në përputhje me kërkesat e vazhdueshme të Rregullës së KQZ-së nr. 01/2013

Subjekti Politik mirëmban llogari kryesore bankare ne bankën RBKO.

Kryetar i Partisë është Veton Berisha.

Numri fiskal 601140396

**Shënimi 2. Toka, objektet dhe pajisjet
Me 31 Dhjetor 2014**

	Bilanci në fillim të vitit (kosto historike)	Blerjet gjatë vitit	Zhvlerësimi i akumuluar	Zhvlerësimi i vitit	Bilanci në fundë të vitit (vlera neto)
Toka			////////////////////		0.00
Objektet					0.00
Veturat					0.00
Pajisjet e zyrës		851.00			851.00
Pajisjet e teknologjisë informative		1,795.00			1,795.00
Pajisjet tjera					0.00
Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet	0.00	2,646.00	0.00	0.00	2,646.00

Shënimi 3 . Shpenzimet

Shpenzimet	Shpenzimi ne Euro	Pagesa ne Euro	Borxhi i mbetur ne Euro
Pagat dhe kompensimet			
Pagat dhe kompensimet, neto		2,290.00	(2,290.00)
Kontributi pensional nga punëmarrësi			-
Kontributi pensional nga punëdhënësi			-
Tatimi ne te ardhura personale			-
Benificionet te tjera			-
Gjithsej pagat dhe kompensimet	-	2,290.00	(2,290.00)
Shpenzimet e transportit			
Automjetet motorike te huazuara			-
Karburantet		1,727.00	(1,727.00)
Biletat, ajroplanit/autobusi,trenit,taxi etj			-
Sigurimi dhe mirëmbajtja e veturave			-
Çdo sigurim tjetër transporti			-
Gjithsej shpenzimet e transportit	-	1,727.00	(1,727.00)
Reklama, reprezentacioni dhe konferencat			
Lokali			-
Ushqimi		2,521.35	(2,521.35)
Aktivitetet kulturore dhe rekreative			-
Radio dhe spote televizive			-
Stenda e afishimi dhe reklamimet ne gazeta			-
Shpenzimet e tjera reklama, reprezentacioni dhe konferencat		996.60	(996.60)
Gjithsej reklama, reprezentacioni dhe konferencat	-	3,517.95	(3,517.95)
Shpenzimet e fushatës			
Shpenzimet e fushatës			-
Gjithsej shpenzimet e fushatës	-	-	-
Blerja e mallrave			
Furnizime ne zyre		832.60	(832.60)
Pajisjet e vogla		18.40	(18.40)
Gjithsej blerja e mallrave	-	851.00	(851.00)
Shpenzimet e përgjithshme			
Qiraja e lokalit te zyrës		1,000.00	(1,000.00)
Telefoni, interneti dhe posta		177.00	(177.00)
Rryma, shërbimet komunale(uji dhe mbeturinat)		1,795.00	(1,795.00)
Shpenzimet e zhvlerësimit te pasuritë afatgjate	0.00		
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe			

Partia Liberale Egjiptiane*Shënime për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2014 deri më 31 Dhjetor, 2014*

kontributet ne natyre ne mallra dhe sherbime			
Gjithsej shpenzimet e përgjithshme	-	2,972.00	(2,972.00)
Shpenzimet e ndryshme			
Mirëmbajta e pajisjeve dhe hapësira e zyrave			-
Shpenzimet qe nuk janë përfshi ne asnjë kategori tjetër	0.00	249.50	(249.50)
Gjithsej shpenzimet e ndryshme	-	249.50	(249.50)
Gjithsej shpenzimet			
	-	11,607.45	(11,607.45)